



Naša uprava

institut alternativa

CIN Centër i Intermedialitetit dhe Kulturës

NH NEW HORIZON Civil Society Organization

Natura NVO Natura-Kolëtin



ADMINISTRATA PUBLIKE DERI NË VITIN 2020



PËR NJË ADMINISTRATË QË PRANON MENDIME TË NDRYSHME

Deri në vitin 2020, në procesin e vendimmarrjes organet administrative duhet që sa më shumë të konsultohen me qytetarët dhe të kryejnë vlerësimin e nevojshëm në mënyrë që të sigurohet zbatueshmëria e vendimeve të tyre.


Objektivat kryesore të Strategjisë së Administratës Publike në këtë fushë janë:

KRIJIMI I NJË SISTEMI PLANIFIKIMI GJITHËPËRFSHIRËS DHE RACIONAL, KOORDINIMI DHE MONITORIMI TË REALIZIMIT TË POLITIKAVE PUBLIKE

Aktualisht, në nivel Qeverie nuk ekziston ndonjë sistem planifikimi afat-mesëm. E thënë ndryshe, përveç prezantimit të kandidatit për kryeministër dhe programit të punës së Qeverisë, i cili miratohet çdo vit, nuk ka asnjë dokument tjetër planifikimi. Pas miratimit të programit katërvjeçar të punës së Qeverisë, në tremujorin e parë të vitit 2017, nuk do duhej të ndodhin më këto situata.



POLITIKËBËRJE MË CILËSORE, E BAZUAR NË ANALIZA GJITHËPËRFSHIRËSE DHE KONSULTIME NDËRMJET AKTORËVE TË NDRYSHËM



Administrata jonë rrallëherë analizon ndikimin që ligjet mund të kenë në ekonomi dhe tek qytetarët. Gjithashtu, pjesëmarrja e qytetarëve në hartimin e politikave publike nuk është në nivel të kënaqshëm.



Kjo broshurë u krijua në kuadër të projektit 'Shoqëria Civile për Qeverisje të Mirë: Shërbim dhe Meritë', që financohet nga Bashkimi Evropian dhe implementohet nga Instituti Alternativa, Bonum, Natura, Horizonti i Ri dhe Qendra për Gazetari Hulumtuese. Përbajtja e kësaj broshure është përgjegjësi vetëm e autorit dhe në asnjë mënyrë nuk paraqet qëndrimet e Bashkimit Evropian.